



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 05, datë 15.01.2021

MBI

**ANULIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 226, DATË 15.12.2020 “MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 209, SERIA T13, PËR  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË  
SHOQËRISË “SHUTINA ENERGJI” SH.P.K. ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S  
NR. 109, DATË 01.10.2013.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, pikës 2 të nenit 117 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.01.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 143/2 prot, datë 30.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, *Mbi anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 226, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SHUTINA ENERGJI” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 01.10.2013,*

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e ERE-s nr. 1172/1 prot, datë 04.11.2020, shoqëria “SHUTINA ENERGJI” sh.p.k. është njoftuar për nisjen e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s nga ana e saj, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së kësaj debie.
- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “SHUTINA ENERGJI” sh.p.k, nuk kishte përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 226, datë 15.12.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SHUTINA ENERGJI” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 01.10.2013, për shkak se shoqëria nuk ka shlyer në afat pagesën e rregullimit për vitin 2019.

- Shoqëria u njoftua për vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 226, datë 15.12.2020. me shkresën nr. 1172/1-3 Prot, datë 23.12.2020.
- Me e-mailin e datës 29.12.2020, në adresën e postës elektronike të ERE-s, shoqëria “SHUTINA ENERGI” sh.p.k. ka deklaruar se e ka shlyer pagesën e rregullimit ndaj ERE-s dhe se për këtë ka depozituar në ERE dokumentacionin përkatës vërtetues.
- Pas rakordimit ka rezultuar se është bërë një gabim material në database-in e të dhënave në lidhje me debitorët ndaj ERE, për pagesat e rregullimit korrente dhe ato të prapambetura, dhe shoqëria “SHUTINA ENERGI” sh.p.k., si rrejdhojë e këtij gabimi material rezultonte debitorë për pagesat e rregullimit të prapambetura të vitit 2019.
- Me konstatimin e sa më sipër, rezulton se shkak ligjor për të cilin ERE vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SHUTINA ENERGI” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 01.10.2013, nuk ekziston dhe për rrjedhojë vendimi i Bordit të ERE Nr. 226, datë 15.12.2020, është marrë në kushtet e një gabimi material në të dhënat që shërbyen si shkak ligjor për marrjen e tij.
- Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë parashikohet si vijon:
  1. *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.*
  2. *Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.*
- Në pikën 2 të nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë parashikohet si vijon:
 

*Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.*
- Me anulimin e vendimit të ERE nr. 226, datë 15.12.2020, ndryshon statusi i të licencuarit “SHUTINA ENERGI” shpk në raport me ERE, nga debitor në jodebitor.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 226, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SHUTINA ENERGI” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 01.10.2013”.

2. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.